



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



**Këshilli Gjyqësor i Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 7 paragrafi 1.24 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenit 39, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L – 054 për Gjykatat, në mbledhjen e mbajtur më datën 31 maj 2022,

**Miratton :**

**RREGULLORE Nr. 03/2022**

**PËR PROCEDURËN E CERTIFIKIMIT, EMËRIMIT, KUSHTET, TË DREJTAT,  
DETYRIMET DHE SHPËRBLIMIN E EKSPERTËVE GJYQËSOR**

**Neni 1**

**Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Me këtë rregullore përcaktohet procedura e certifikimit, emërimit, kushtet, të drejtat dhe detyrimet e ekspertëve gjyqësor si dhe lartësia e shpërblimit për punën e tyre.
2. Fushëveprim i kësaj rregullore janë ekspertët gjyqësor të cilët aplikojnë, certifikohen dhe emërohen nga Këshilli si ekspert gjyqësor.

**Neni 2**

**Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:
  - 1.1. **Këshilli** – Këshilli Gjyqësor i Kosovës siç është përcaktuara me Ligjin për Këshilli Gjyqësor të Kosovës;
  - 1.2. **Njësia** – Njësia për Inspektim Gjyqësor siç është përcaktuara me Ligjin për Këshilli Gjyqësor të Kosovës;

- 1.3. **Ekspert gjyqësor** – personi fizik apo juridik i regjistruar në regjistrin e ekspertëve gjyqësor;
- 1.4. **Ekspertiza**- për qëllime të kësaj rregulloreje ka kuptimin e mendimit profesional të dhënë nga eksperti gjyqësor i angazhuar;
- 1.5. **Regjistri** – Regjistri i ekspertëve gjyqësor të certifikuar dhe emëruar nga Këshilli;
- 1.6. **Komisioni për vlerësimin e aplikacionit të kandidatit për ekspert gjyqësor** – Komisioni i themeluar nga Këshilli i cili shqyrton, analizon dhe vlerëson aplikacionin e kandidatit dhe dokumentet e bashkangjitura;
- 1.7. **Komisioni për shqyrtimin e Ankesave** - Komisioni i themeluar nga Këshilli për shqyrtimin e ankesave;
- 1.8. **Komisioni Ad Hoc** – Komisioni i themeluar nga ana e Këshillit për të shqyrtuar dhe vlerësuar sjelljen e pahijshme të ekspertit gjyqësor.

### **Neni 3** **Parimet e përgjithshme**

1. Eksperti gjyqësor ushtron detyrat e tij në pajtim me rregullat dhe parimet e përgjithshme, përfshirë parimin e ligjshmërisë, pavarësisë, paanshmërisë, konfidencialitetit dhe profesionalizimit.
2. Eksperti gjyqësor zbaton udhëzimet sipas standardeve aktuale të shkencës, teknologjisë, përvojës dhe kujdesit të duhur.
3. Përgatitja e mendimit dhe konstatimit të ekspertit duhet të jetë objektive dhe e paanshme. Gjatë përpilimit të ekspertizës, eksperti duhet t'i shmangët paragjykimet si dhe pranimit të përfitimeve tjera, përveç shpërblimit të përcaktuar me këtë rregullore.
4. Eksperti duhet të deklarojë në fillim të procedurave gjyqësore se nuk ka ndonjë konflikt të mundshëm të interesit. Në rast se paraqitet konflikti i mundshëm i interesit ai/ajo duhet menjëherë të njoftojë të gjitha palët e interesuara dhe mund të tërhiqet nga caktimi i tij në rastin përkatës.

### **Neni 4** **Komisioni për Vlerësimin e Aplikacionit të Kandidatit për Ekspert Gjyqësor**

1. Komisioni për Vlerësimin e Aplikacionit të Kandidatit për Ekspert Gjyqësor themelohet nga Këshilli, i cili përbëhet nga tre (3) anëtarë, njëri nga të cilët duhet të jetë anëtar gjyqtar i Këshillit dhe dy (2) anëtarë të tjerë nga radhët e gjyqtarëve të gjykatave të Republikës së Kosovës dhe dy (2) anëtarë rezervë, prej të cilëve njëri vjen nga anëtarët gjyqtarë të Këshillit, kurse tjetri nga radhët e gjyqtarëve të gjykatave të Republikës Kosovës.

2. Përbërja e Komisionit për Vlerësimin e Aplikacioneve të Kandidatit për Ekspert Gjyqësor duhet të pasqyrojë strukturën etnike dhe gjinore të gjyqësorit.

3. Komisioni për Vlerësimin e Aplikacionit të Kandidatëve për Ekspert Gjyqësor mbështetet nga stafi i Njësisë.

#### **Neni 5**

#### **Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave**

1. Këshilli, për çdo konkurs të hapur, themelon Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave në bazë të kriterëve të Ligjit, Rregullores Nr.03/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe me këtë Rregullore.

2. Komisioni zgjidhet në përbërje prej tre (3) anëtareve të rregullt dhe dy (2) anëtarë rezerve nga radhët e gjyqtareve të gjykatave të Republikës së Kosovës.

3. Këshilli zgjedh kryetarin e komisionit nga radhët e anëtareve të rregullt të Komisionit për Shqyrtimin e ankesave.

4. Gjatë vendosjes për përbërjen e Komisionit për Shqyrtim, Këshilli merr parasysh parimin e barazisë gjinore dhe përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë.

5. Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të kandidatit për ekspert gjyqësor, të paraqitura ndaj vendimeve të Komisionit për Vlerësimin e Aplikacioneve të kandidatit.

#### **Neni 6**

#### **Shpallja e konkursit**

1. Këshilli, shpall konkurs për certifikimin dhe emërimin e ekspertit gjyqësor, i cili publikohet së paku në një (1) nga mjetet e informimit në tërë territorin e Republikës së Kosovës, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit. Me qëllim të informimit të kandidatëve nga komunitetet jo-shumicë, konkursi gjithashtu publikohet në mjete të informimit publik të komuniteteve jo-shumicë, në gjuhët zyrtare që janë në përdorim në Republikën e Kosovës.

2. Këshilli vendos për kohën e shpalljes së konkursit, varësisht prej nevojës dhe kërkesës.

#### **Neni 7**

#### **Kushtet e përgjithshme për certifikimin e eksperteve gjyqësor**

1. Për t'u certifikuar si ekspert gjyqësor, kandidati duhet t'i plotësojë kushtet e përgjithshme si në vijim:

- 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- 1.2. të ketë zotësi të plotë të veprimit;
- 1.3. të ketë diplomë universitare në fushën përkatëse;
- 1.4. të mos jetë i dënuar për vepër penale, në përjashtim të veprës penale të kryer nga pakujdesia;
- 1.5. të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale në fushën specifike apo të ngjashme; dhe,
- 1.6. të mos i jetë shqiptuar sanksioni ndalim i kryerjes së profesionit, detyrës apo veprimtarisë me vendim të plotfuqishëm të gjykatës.

2. Përveç kushteve të përgjithshme, kandidati për t'u certifikuar ekspert gjyqësor duhet ta dëshmojë kompetencë dhe ekspertizë profesionale të tij/të saj me anë të kushteve specifike dhe mbështetëse, si në vijim:

- 2.1. Kualifikime profesionale që i ka arritur kandidati dhe që janë relevante për fushën e ekspertizës;
- 2.2. Trajnime dhe kurse të veçanta në të cilat kandidati ka marrë pjesë dhe që janë relevante për fushën përkatëse të ekspertizës;
- 2.3. Çmime, botime ose përvoja mësimore relevante për fushën e ekspertizës; dhe,
- 2.4. Përvojë dhe aftësi profesionale të kandidatit, relevante për fushën e ekspertizës.

3. Përjashtimisht nga dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, si ekspert gjyqësor mund të angazhohet edhe personi i cili ka njohuri në fushat specifike për të cilat mungojnë ekspertë të diplomuar nga universitetet përkatëse.

## **Neni 8**

### **Dokumentet e nevojshme dhe mënyra e aplikimit**

1. Kandidati duhet të dorëzojnë dokumentet si në vijim:

- 1.1. Aplikacionin e plotësuar me të dhënat e kërkuara;
- 1.2. Certifikatën e shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- 1.3. Diplomën Universitare përkatëse të vlefshme në Republikën e Kosovës;
- 1.4. Dëshminë mbi përvojën e punës përkatëse, të përcaktuar me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi;
- 1.5. Certifikatën shëndetësore për vlerësimin e aftësive psiko-fizike;
- 1.6. Certifikatën nga evidenca penale lëshuar nga gjykata, si dhe;
- 1.7. Dokumentet tjera/dëshmitë e përcaktuara si në nenin 7 paragrafi 2 i kësaj rregullore.

2. Aplikacioni së bashku me dokumentet mbështetëse mund të dorëzohet në Këshill në formë fizike, përmes postës së rregullt ose postës elektronike, i cili regjistrohet dhe secili kandidat pajiset me një konfirmim mbi pranimin e aplikacionit.

3. Për secilin kandidat krijohet dosje e cila përmban të gjitha dokumentet e prezantuar nga kandidati. Komisioni për Vlerësimin e Aplikacioneve të Kandidatit për Ekspert Gjqësor është përgjegjës për formimin, mbajtjen e dosjes dhe siguron kompletimin dhe përditësimin e saj deri në momentin e përmbylljes përfundimtare të procesit të emërimit.

4. Kandidati në aplikacion cakton fushën e tij të ekspertizës për të cilën kërkon të certifikohet.

5. Kandidati i cili aplikon për t'u certifikuar si ekspert gjyqësor në fushën e caktuar duhet të paguajë taksën prej pesëdhjetë (50) euro. Dëshmia për pagesën dorëzohet në momentin e aplikimit dhe nuk është e rimbursueshme.

## **Neni 9**

### **Procedura e vlerësimit të aplikacionit**

1. Pas përmbylljes së konkursit, Komisioni për Vlerësimin e Aplikacioneve të Kandidatit për Ekspert Gjqësor shqyrton aplikacionet e kandidatëve brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve, nga dita e mbylljes së konkursit.

2. Gjatë shqyrtimit të aplikacioneve, Komisioni për Vlerësimin e Aplikacioneve të Kandidatit për Ekspert Gjqësor, përmes Njësisë mund të kërkojë informacion shtesë dhe verifikim të të dhënave nga institucionet përkatëse. Në raste të tilla, procedura e shqyrtimit të dokumentacionit pezullohet deri në pranimin e të dhënave të kërkuara nga institucioni përkatës.

3. Komisioni për Vlerësimin e Aplikacioneve të Kandidatit për Ekspert Gjqësor, pas kryerjes së verifikimit përpilon një raport shpjegues, në të cilin përmbledhë shkurtimisht të dhënat e dokumentacionit të paraqitura dhe informacionin nëse janë përmbushur kushtet e përgjithshme nga kandidati.

4. Kandidati i cili nuk i plotëson kushtet e përgjithshme sipas kësaj rregullore njoftohet nga ana e Komisionit për Vlerësimin e Aplikacioneve të Kandidatit për Ekspert Gjqësor në afat prej pesë (5) ditëve nga dita e përfundimit të procesit të shqyrtimit të aplikacioneve. Kandidati ka të drejtë ankese pranë Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, në afat prej tre (3) ditë pune nga marrja e njoftimit.

5. Komisioni për shqyrtim të ankesave, shqyrton ankesën e kandidatit brenda tetë (8) ditëve nga dita e përfundimit të afatit për paraqitjen e ankesës. Komisioni i Ankesave ka të drejtë të miratojë, refuzojë ose ta hedhë ankesën.

6. Nëse Komisioni për shqyrtim të ankesave vlerëson se kandidati i plotëson kushtet e përgjithshme, i njëjti vendoset në listën e kandidateve që i plotësojnë kushtet dhe i nënshtrohet procedurave të emërimit sipas dispozitave të kësaj rregullore.

## **Neni 10**

### **Certifikimi dhe emërimi i kandidatëve**

1. Jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të procedurës së ankesave, Komisioni për Vlerësimin e Aplikacioneve të Kandidatit për Ekspert Gjyqësor i dërgon Këshillit listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet sipas kësaj rregullore.

2. Këshilli, pas shqyrtimit dhe miratimit të listës së kandidatëve të propozuar nga Komisioni për Vlerësimin e Kandidatëve për Ekspert Gjyqësor, me vendim i certifikon dhe emëron ekspertët gjyqësor.

3. Pas certifikimit dhe emërimit, Këshilli lëshon certifikatën e ekspertit gjyqësor me këtë përmbajtje:

- 3.1. logon e Republikës së Kosovës dhe të Këshillit;
- 3.2. numrin dhe datën kur është lëshuar certifikata;
- 3.3. fushën specifike për të cilën certifikohet;
- 3.4. emrin, emrin e prindit, mbiemrin dhe numrin personal;
- 3.5. nënshkrimin e Kryesuesit të Këshillit; dhe
- 3.6. vulën zyrtare të Këshillit.

4. Me rastin e certifikimit eksperti gjyqësor detyrohet të paguaj shumën prej dyqind e pesëdhjetë (250) euro. Pas pranimit të dëshmisë për pagesën e kryer dhe emërimit nga ana e Këshillit, eksperti gjyqësor do të pajiset me certifikatë dhe regjistrohet në regjistër siç përcaktohet me këtë rregullore.

5. Çdo anëtar i shoqatës profesionale, institucionit arsimor, institucionit kërkimor dhe çdo subjekt tjetër që i plotëson kushtet sipas kësaj rregullore gëzon të drejta të barabarta sa i përket qasjes në procedurat gjyqësore dhe mund të caktohet nga gjyqtari si ekspert gjyqësor.

## **Neni 11**

### **Kartela identifikuese dhe vula**

1. Çdo ekspert gjyqësor duhet të ketë kartelë identifikuese dhe vulë. Format i kartelës dhe vulës përcaktohet nga Këshilli.

2. Kartela e ekspertit gjyqësor lëshohet nga Këshilli dhe duhet të përmbajë:

- 2.1. logon e Këshillit;
- 2.2. numrin e certifikatës;
- 2.3. emrin dhe mbiemrin;
- 2.4. fushën për të cilën është certifikuar;
- 2.5. datën e lëshimit; dhe,
- 2.6. foto.

3. Vula duhet të jetë për fushën për të cilën është certifikuar.

4. Forma e vulës duhet të jetë e rrumbullakët, me diametër 40 mm, në gjuhët zyrtare, në të cilën duhet të shënohet:

- 4.1. në rrethin e parë: Republika e Kosovës;
- 4.2. në rrethin e dytë: Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
- 4.3. në rrethin e mbetur (në mes): emri dhe mbiemri i ekspertit gjyqësor dhe fusha për të cilën është certifikuar.

5. Eksperti gjyqësor duhet ta deponojë nënshkrimin dhe kopjen e vulës në Këshill. Përshtatshëmrisht kur të krijohen kushtet, ekspertit gjyqësor mund të deponojë nënshkrimin dhe vulën elektronike.

6. Përmbajtja e tekstit standard që vërteton saktësinë e ekspertizës sigurohet nga Këshilli për të gjithë ekspertet gjyqësor.

## **Neni 12**

### **Regjistri**

1. Eksperti i emëruar nga Këshilli regjistrohen në Regjistrin e Ekspertëve gjyqësor.

2. Regjistri i ekspertëve gjyqësor të emëruar përmban informatat identifikuese përfshirë numrin kontaktues, e-mail adresën, adresën e vendbanimit/vendqëndrimit.

3. Regjistri specifikon fushën për të cilën eksperti gjyqësor i emëruar është kompetent.

4. Eksperti gjyqësor i emëruar duhet ta njoftojë menjëherë Këshillin për çdo ndryshim të të dhënave të përfshira në Regjistrë.

5. Regjistri publikohet në faqen zyrtare të Këshillit dhe në gazetën zyrtare.

6. Këshilli administron regjistrin e të gjithë ekspertëve të emëruar dhe një herë në çdo dy (2) vjet, bën verifikimin e të dhënave për çdo ekspert me qëllim të çregjistrimit të ekspertëve të cilët nuk plotësojnë më kushtet e përgjithshme ose për të cilët është paraqitur një pengesë për vijimin e ushtrimit të profesionit.

### **Neni 13**

#### **Caktimi i ekspertit**

1. Gjyqtari i çështjes cakton ekspertin gjyqësor të certifikuar dhe emëruar nga Këshilli për llojin e caktuar të ekspertimit nga regjistri i ekspertëve gjyqësor.

2. Sipas rastit dhe vlerësimit të gjyqtarit, ekspertizat me të ndërlikuara i besohen në rend të parë institucioneve publike apo institucioneve tjera të specializuara në fushën përkatëse.

### **Neni 14**

#### **Të drejtat dhe detyrimet e ekspertit gjyqësor**

1. Eksperti gjyqësor ka të drejtë të refuzojë caktimin e tij nëse nuk është në gjendje të kryejë detyrën në mënyrë të paanshme, të pavarur, për arsye të çfarë do llojit të konfliktit të interesit ose për ndonjë arsye tjetër.

2. Eksperti gjyqësor ka të drejtë të marrë të dhëna dhe udhëzime përmes pyetjeve nga: palët, institucionet përkatëse (publike dhe private) si nga persona të tretë brenda kufijve të nevojshëm për kryerjen e detyrës së tij/saj, me qëllim të dhënies së mendimit të plotë, saktë dhe konkret. Po ashtu, eksperti gjyqësor, ka të drejtë të informohet dhe këshillohet për të drejtat dhe detyrat e tij si ekspert.

3. Eksperti gjyqësor sipas vendimit të kryetarit të trupit gjykues / gjyqtarit, ka të drejtë të ketë qasje në të gjitha objektet, personat, të dhënat dhe ngjarjet që shqyrtohen dhe vlerësohen në lidhje me ekspertizën.

4. Eksperti gjyqësor është i obliguar t'u përmbahet afateve të caktuara në vendimin e kryetarit të trupit gjykues/gjyqtarit për hartimin e ekspertizës.



5. Në qoftë se eksperti gjyqësor për shkak të arsyeve objektive nuk mund të përfundojë ekspertizën në afatin e caktuar nga gjykata, është i obliguar që ta njoftojë gjykatën për arsyet e mos përfundimit të ekspertizës, rrjedhimisht të kërkoj zgjatjen e afatit për përfundimin e ekspertizës.

6. Eksperti gjyqësor është i obliguar ta mbajë konfidenciale çdo informatë ose rezultat me të cilin përballet gjatë ekspertizës.

7. Eksperti gjyqësor është i obliguar ta respektojë gjykatën dhe palët, si dhe të marrë përsipër lëndët që i caktohen.

7.1. Në qoftë se nuk respekton gjykatën, palët, refuzon pa arsye të kryej ekspertizën, nuk jep sqarim mbi faktin që nuk ka mbaruar ekspertizën brenda afateve të caktuara apo për arsye tjera serioze, kryetari i trupit gjykues / gjyqtari përveç masave të cilat mund t'i ndër marrë konform dispozitave të ligjeve të aplikueshme të cilat zbatohen në raport me ekspertët, ka mundësi që përmes kryetarit të gjykatës përkatëse të paraqes ankesë në Këshill, siç shprehimisht përcaktohet me dispozitën e nenit 19 paragrafi 1 të kësaj Rregullore.

## **Neni 15**

### **Kompensimi i ekspertëve gjyqësor**

1. Eksperti gjyqësor që caktohet me vendim të gjykatës përkatësisht kryetarit të trupit gjykues/ gjyqtarit gëzon të drejtën e shpërblimit për ekspertizën e bërë dhe shërbimet e kryera sipas tarifës së përcaktuar me këtë rregullore.

2. Kur caktimi i ekspertit gjyqësor kërkohet nga pala, kryetari i trupit gjykues /gjyqtari e cakton me aktvendim ekspertin si dhe e obligon palën të deponojë në llogarinë bankare përmes arkës së gjykatës një shumë të caktuar të hollash në emër të ekspertizës dhe dëshminë mbi deponimin e të hollave t'ia bashkëngjisë shkresave të lëndës përkatëse.

3. Në rastet kur shuma e të hollave të deponuara në arkën e gjykatës për ekspertizë është më e lartë se shuma e cila duhet t'i paguhet ekspertit, ajo shumë do t'i kthehet palës e cila e ka bërë deponimin e të hollave në arkë.

4. Eksperti gjyqësor për ekspertizën e bërë dhe pjesëmarrjen në seancë do të paguhet si në vijim:

4.1. në shumën prej pesëdhjetë (50) deri në njëqind e pesëdhjetë (150) euro;

4.2. në shumën prej njëqind e pesëdhjetë (150) deri në pesëqind (500) euro për lëndët më komplekse;

4.3. për çështjet ekonomike kur shuma e kontestit nuk tejkalon një milion (1,000,000) euro shuma maksimale që mund të paguhet është deri në një mijë (1,000) euro;

- 4.4. për raste jashtëzakonisht komplekse në të gjitha procedurat pa marrë parasysh shumën e kontestit dhe çështje ekonomike në rastet kur shuma e kontestit tejkalon një milion (1,000,000) euro, shuma maksimale që mund të paguhet është deri në dy mijë (2,000) euro.
- 4.5. Për rastet e plotësimit të ekspertizës pa fajin e ekspertit, gjykata mund të caktoj shumën për plotësimin e ekspertizës deri në gjysmën e shumës së përcaktuar për ekspertizë.

## **Neni 16**

### **Lista e ekspertëve të institucioneve publike dhe institucioneve të specializuara**

1. Të gjitha institucionet publike dhe ato të specializuara janë përgjegjëse për të përgatitur listën e ekspertëve që mbulojnë fushën përkatëse të ekspertizës dhe këtë listë ia dorëzojnë Këshillit më së largu në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes publike të bërë nga Këshilli.
2. Këshilli do të njohë në mënyrë automatike listat e pranuar dhe të njëjtat do të jenë pjesë e regjistrit të ekspertëve gjyqësor të emëruar sipas kësaj rregullore.

## **Neni 17**

### **Shpërblimi i ekspertëve gjyqësor**

1. Institucionet publike dhe ato të specializuara janë përgjegjëse që Këshillit t'ia dorëzojnë listën e shërbimeve të cilat i ofrojnë me pagesë si dhe propozimet e tarifave për shpërblim.
2. Këshilli do t'i shqyrtoj tarifat e propozuara nga institucionet publike dhe ato të specializuara, të cilat nuk përfshihen në nenin 15 të kësaj rregullore dhe pas miratimit të tyre nga Këshilli, të njëjtat do të bashkëngjiten si shtojcë e kësaj rregullore.
3. Në rastet kur ekspertiza kryhet nga eksperti i cili veprimtarinë e tij e ushtron në kuadër të një institucioni publik apo institucionit të specializuar përkatës, shpërblimi për punën e kryer do t'i paguhet ekspertit, sipas tarifës së përcaktuar me këtë rregullore.
4. Në rastet kur ekspertiza sipas kërkesës së gjykatës kryhet nga institucioni publik apo i specializuar, shpërblimi për punën e kryer do t'i paguhet institucionit, sipas tarifës së përcaktuar me këtë rregullore.
5. Në rastet kur ekspertiza kryhet nga eksperti i pavarur që mbulon fushën përkatëse por që nuk është pjesë e institucioneve publike apo të specializuara, zbatohen dispozitat e kësaj rregullore sa i përket shpërblimit të ekspertit të caktuar nga gjykata.

6. Në rastet kur shpërblimi për ekspertizë bëhet nga buxheti i Këshillit, gjykata është e obliguar që pas përfundimit të seancës gjyqësore të plotësojë formularin për shpërblimin e lejuar. Forma dhe përmbajtja e formularit për shpërblim do të miratohet nga Këshilli si shtojcë e veçante e kësaj rregullore.

7. Gjkata në të gjitha rastet shpërblimin për ekspertizë e cakton përmes nxjerrjes së aktvendimit të veçantë bazuar në tarifat e përcaktuara me këtë rregullore, i cili aktvendim përveç tjerash duhet të përmbajë: emrin dhe mbiemrin e ekspertit /institucionit, numrin personal, numrin fiskal/biznesit dhe numrin e xhirrollogarisë bankare.

### **Neni 18**

#### **Pezullimi i ekspertit gjyqësor dhe revokimi i certifikatës**

1. Nëse ndaj ekspertit gjyqësor caktohet masa e ndalimit sipas Kodit të Procedurës Penale apo kur eksperti gjyqësor është në një proces gjyqësor si i akuzuar, Këshilli bën pezullimin e ekspertit gjyqësor deri në përfundim të procesit gjyqësor.

2. Nëse eksperti gjyqësor bën kërkesë për pezullim të angazhimit si ekspert gjyqësor për një kohë të caktuar, Këshilli vendos për pezullim nga lista për aq kohë sa është kërkuar nga vet eksperti gjyqësor.

3. Ndaj ekspertit gjyqësor i cili është certifikuar nga Këshilli, Këshilli bën revokimin e certifikatës së ekspertit gjyqësor nëse:

- 3.1. nuk kanë ekzistuar ose kanë pushuar së ekzistuari kushtet në bazë të të cilave eksperti është certifikuar;
- 3.2. është dënuar për vepër penale në përjashtim të veprës penale të kryer nga pakujdesia;
- 3.3. në mënyrë të përsëritur e kryen punën me pandërgjegjshmëri, në mënyrë të pa rregullt dhe jo profesionale;
- 3.4. refuzon pa arsye të kryej ekspertizën;
- 3.5. pa arsye nuk iu përgjigjet ftesave të gjykatës, më tepër se tri (3) herë me ndërprerje dhe pandërprerë dhe lidhur me këtë nuk ofron arsyetim të justifikueshëm në momentin kur ftohet; dhe
- 3.6. përkundër thirrjes së gjykatës, pa arsye nuk e përfundon ekspertizën në kohën e caktuar.

**Neni 19**  
**Largimi nga lista e ekspertit gjyqësor**

1. Në rast kur ndaj ekspertit të thirrur në gjykatë paraqiten ankesa lidhur me sjelljen e pahijshme të tij / saj ndaj gjykatës apo palëve në proces ose për mos përmbushjen e detyrimeve profesionale /ligjore nga ana e tij/saj në mënyrë të përsëritur, kryetari i trupit gjykues / gjyqtari përmes kryetarit të gjykatës paraqet ankesën në Këshill.
2. Këshilli themelon një Komision Ad-Hoc (tutje: komisioni) në përbërje prej tre (3) anëtareve dhe dy (2) anëtarë rezerve nga radhët e gjyqtareve të gjykatave të Republikës së Kosovës.
3. Komisioni benë shqyrtimin e ankesës në bazë të të dhënave të paraqitura nga gjykata mbi procesin gjyqësor në të cilën pretendohet se eksperti gjyqësor nuk ka përmbushur detyrimet ligjore. Komisioni, i kërkon ekspertit gjyqësor përgjigjet e tij në lidhje me supozimet e parashtruara në ankesën e paraqitur.
4. Komisioni mund ta refuzoj ankesën ose t'i rekomandon Këshillit largimin e ekspertit gjyqësor nga lista në bazë të raportit të përgatitur pas shqyrtimit të ankesës.
5. Këshilli, pas shqyrtimit të raportit të Komisionit me të cilin është rekomanduar masa e largimit të ekspertit gjyqësor nga lista e eksperteve gjyqësor, me vendim mund të largoj nga lista ekspertin gjyqësor duke shfuqizuar vendimin për certifikim dhe emërim të tij.
6. Eksperti gjyqësor mund të largohet nga lista edhe për arsyet si në vijim:
  - 6.1. me kërkesën e tij / dorëheqje;
  - 6.2. në rast të vdekjes;
  - 6.3. në rast të humbjes së zotësisë së veprimit;

**Neni 20**  
**Ankesa ndaj vendimit**

Eksperti gjyqësor ndaj vendimit të Këshillit për largim nga lista e ekspertit gjyqësor, shfuqizimit të vendimit për certifikim dhe emërim, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështje administrative.

**Neni 21**  
**Zbatimi**

Këshilli Gjyqësor i Kosovës për zbatimin e kësaj rregulloreje mund të lidhë marrëveshje mirëkuptimi me institucione tjera përkatëse.

**Neni 22**  
**Dispozita shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet Rregullore Nr.15/2015 për Emërimin e Ekspertëve Gjyqësor dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore që bien ndesh me këtë rregullore.

**Neni 23**  
**Dispozita kalimtare**

1. Për të gjitha ekspertizat e kryera nga institucionet publike dhe të specializuara e të cilat nuk janë shpërblyer, barra e shpërblimit bie mbi organin i cili ka lëshuar urdhër për kryerjen e ekspertizës. Shpërblimi sipas kësaj dispozite duhet të bëhet pas miratimit të shtojcave lidhur me tarifat e shpërblimit në Këshill, por jo me vonë se nëntëdhjetë (90) ditë nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore.
2. Regjistri i ekspertëve gjyqësor aktual vlen deri në certifikimin dhe emërimin e ekspertëve të rinjë, jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore.
3. Ekspertët gjyqësor aktual i nënshtrohen procedurës së certifikimit dhe emërimit sipas kësaj rregullore.

**Neni 24**  
**Shtojcat e rregullores**

Shtojcat që i janë bashkangjitur kësaj rregullore janë pjesë përbërëse të saj:

- Shtojca 1: Aplikacioni për certifikimin dhe emërimin e ekspertit gjyqësor;
- Shtojca 2: Deklarata për anëtarët e komisionit; dhe,
- Shtojca 3: forma e certifikatës.

**Neni 25**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Albert Zogaj  
  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës  
Datë: 07.06.2022



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**FORMULAR PËR APLIKIM PËR EKSPERT GJYQËSOR**  
**OBRAZAC ZA PRIJAVLJIVANJE ZA SUDSKOG VEŠTAKA**

*TË DHËNAT PERSONALE/LIÇNI PODACI*

Emri/Ime	
Mbiemri/Prezime	
Emri i prindit/Ime roditëlja:	
Data dhe Vendi i lindjes/Datum i mesto redenja	
Adresa e banimit/Adresa:	
Numri i telefonit/Broj telefona:	
E-mail adresa/e-mail adresa:	
Nënshtetësia/Drzavljanstvo	
FUSHA PËR TË CILËN APLIKON / OBLAST ZA KOJU SE PRIJAVLJUJE	

*GJUHA E JUAJ AMTARE/VAŠ MATERNJI JEZIK* \_\_\_\_\_

**UDHËZIMET / UPUTSTVA**

- Kandidati duhet të plotësojë aplikacionin në mënyrë elektronike ose me shkrim në mënyrë të qartë duke përdorur lapsin me ngjyrë të kaltër.
  - Kandidat je dužan popuniti prijavu elektronskim ili pismenim putem, čitko i koristeći olovku plave boje.*
- Kandidati është i obliguar të shënojë „P/P“ (pa përgjigje) në hapësirën e pyetjes në të cilën nuk ka përgjigje. Aplikacioni i paplotësuar mund të shkaktojë eliminim të kandidatit nga për zgjedhja për pozitën e aplikuar. Të gjitha të dhënat e parashtruara nga kandidati i nënshtrohen procesit të verifikimit.
  - Kandidat je dužan obeležiti određeni prostor sa „B/O“ (bez odgovora) ispod pitanja na koje nema odgovor. Nepotpuna prijava može prouzrokovati eliminaciju kandidata iz daljeg postupka. Navedene informacije od strane kandidata biće podređene procesu verifikacije.*
- Kandidati është i obliguar t'ia bashkëngjisë aplikacionit të gjitha dokumentet e kërkuara sipas Konkursit.
  - Kandidat je dužan da uz prijavu priloži svu traženu dokumentaciju po Konkursu.*
- Kandidati është i obliguar të nënshkruaj aplikacionin dhe shënojë datën e dorëzimit. Aplikacioni i cili nuk është i nënshkruar nuk do të merret parasysh.
  - Kandidat je dužan potpisati prijavu i navesti datum predaje. Nepotpisana prijava neće biti uzeta u obzir.*

5. Aplikacioni pranohet nga KGJK me shënim të datës së aplikimit. Në qoftë se dërgesa bëhet përmes postës, i njëjti do të jetë i vlefshëm nëse mban vulën me datë kur aplikacioni në pozitë të caktuar ishte i mundur sipas Konkursit.

5. *Prijave prima SSK sa naznaçenim datumom prijave. Ukoliko se dostava vrši poštom, ista će se smatrati validnom ukoliko sadrži pečat datuma unutar datuma predviđenih Konkursom, kada se kandidat mogao prijaviti.*

**KUALIFIKIMI PROFESIONAL (JU LUTEMI TË BASHKËLIDHNI FOTOKOPJE TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE) / STRUČNA SPREMA ( MOLIMO VAS PRILOŽITE FOTOKOPIJU DIPLOMA I SERTIFIKATA)**

<b>ARSIMIMI I KANDIDATIT / OBRAZOVANJE KANDIDATA</b>	
<p>Data e marrjes së diplomës apo kualifikimit tjetër akademik</p> <p><i>Datum sticanja diplome ili druge akademske kvalifikacije</i></p>	<p>Shënoni titullin ashtu si qëndron në diplomë duke marrë parasysh edhe emërtimin e institucionit të lartë arsimor, qytetin dhe shtetin</p> <p><i>Upišite zvanje kako je napisano na diplomi, naziv visokoškolske ustanove, grad i državu</i></p>
<p>Data e marrjes së diplomës apo kualifikimit tjetër akademik</p> <p><i>Datum sticanja diplome ili druge akademske kvalifikacije</i></p>	<p>Shënoni titullin ashtu si qëndron në diplomë duke marrë parasysh edhe emërtimin e institucionit të lartë arsimor, qytetin dhe shtetin</p> <p><i>Upišite zvanje kako je napisano na diplomi, naziv visokoškolske ustanove, grad i državu</i></p>
<p>Data e marrjes së diplomës apo kualifikimit tjetër akademik / <i>Datum sticanja diplome ili druge akademske kvalifikacije</i></p>	<p>Shënoni titullin ashtu si qëndron në diplomë duke marrë parasysh edhe emërtimin e institucionit të lartë arsimor, qytetin dhe shtetin</p> <p><i>Upišite zvanje kako je napisano na diplomi, naziv visokoškolske ustanove, grad i državu</i></p>

**TRAJNIME, SPECIALIZIME SHITESË / OBUKA, DODATNA USAVRŠAVANJA**

Trajnime apo specializime shtesë relevante	Shënoni datat e trajnimit, emërtimin e institucionit ku është zhvilluar trajnimi dhe shteti.
Dodatna relevantna usavršavanja ili obuke	Navedite datum obuke, naziv institucije gde je održana obuka i državu.

**PËRDORIMI I KOMPJUTERIT / SLUŽENJE RAÇUNAROM**

Shënoni me „x“ punët /programet të cilat dini t'i përdorni / Označite sa „x“ kompjuterske alatke /programe koje znate koristiti.

Word	<input type="checkbox"/>	Excel	<input type="checkbox"/>	Powerpoint	<input type="checkbox"/>	Të tjera / Ostalo:
Internet	<input type="checkbox"/>	Outlook	<input type="checkbox"/>	Outlook	<input type="checkbox"/>	Të tjera / Ostalo:
PDF Reader	<input type="checkbox"/>	ZIP	<input type="checkbox"/>	Skanim / Skeniranje	<input type="checkbox"/>	Të tjera / Ostalo:

**PËRVOJA E PUNËS / RADNO ISKUSTVO**

Kandidati duhet të fillojë nga vendi i tanishëm i punës apo vendi i fundit i punës ku ka punuar, duke shënuar të gjitha vendet tjera në mënyrë kronologjike nga fundi. Në qoftë se kandidati i duhet hapësirë shtesë, i njëjti mund të shfrytëzojë hapësirën shtesë në fletën që gjendet në fund të aplikacionit, apo mund të shtojë rreshta të rinjë.

*Kandidat treba da počne od trenutnog radnog mesta ili poslednjeg radnog mesta gde je radio, označavajući sva ostala mesta hronološkim redom od kraja. Ako je kandidatu potreban dodatni prostor, on/ona može koristiti dodatni prostor na listu koji se nalazi na kraju prijave ili može dodati nove redove.*

Emri i punëdhënësit / <i>Ime poslodavca</i>	
Titulli / Naziv radnog mesta	
Data dita/muaji/viti (nga - deri) <i>Datum dan/mesec/godina (od-do)</i>	
Përshkrimi i vendit të punës / <i>Opis radnog mesta</i>	



<p>Arsyet për shkëputjen e kontratës së punës /</p> <p><i>Razlozi za prestanak radnog odnosa</i></p>							
<p>Emri i punëdhënësit /</p> <p><i>Ime poslodavca</i></p>							
<p>Titulli / Naziv radnog mesta</p>							
<p>Data dita/muaji/viti (nga - deri)</p> <p><i>Datum dan/mesec/godina (od-do)</i></p>							
<p>Përshkrimi i vendit të punës /</p> <p><i>Opis radnog mesta</i></p>							
<p>Arsyet për shkëputjen e kontratës së punës /</p> <p><i>Razlozi za prestanak radnog</i></p>							
<p>Emri i punëdhënësit /</p>							
<p>Titulli / Naziv radnog mesta</p>							
<p>Data dita/muaji/viti (nga - deri)</p> <p><i>Datum dan/mesec/godina (od-do)</i></p>							
<p>Përshkrimi i vendit të punës /</p> <p><i>Opis radnog mesta</i></p>							
<p>Arsyet për shkëputjen e kontratës së punës /</p>							
<p><b>PËRVOJA E PËRGJITHSHME E PUNËS</b></p> <p><b>UKUPNO RADNO ISKUSTVO</b></p>	<table border="1"> <tr> <td>Vite/Godina</td> <td> </td> <td>Muaj/Meseci</td> </tr> <tr> <td> </td> <td>Ditë/Dana</td> <td></td> </tr> </table>	Vite/Godina		Muaj/Meseci		Ditë/Dana	
Vite/Godina		Muaj/Meseci					
	Ditë/Dana						
<p>Kandidati duhet të theksojë numrin e përgjithshëm të viteve të eksperiencës profesionale pas diplomimit. / Kandidat treba navesti ukupno stručno radno iskustvo nakon sticanja visoke stručne spreme.</p>							

<b>Precedenti penal / Kaznena evidencija</b>					
<p>Kjo pjesë ka pesë (5) pyetje. Përgjigjuni në çdo pyetje me “PO” ose “JO”.</p> <p>Për çdo përgjigje “PO” ju lutemi jepni informatat e kërkuara.</p> <p><i>Ovaj deo ima pet (5) pitanja. Odgovorite na svako pitanje sa “DA” ili “NE”.</i></p> <p><i>Za svaki odgovor sa “DA” molimo vas navedite tražene informacije.</i></p>					
<p>A jeni hetuar ndonjëherë për ndonjë vepër penale?</p> <p><i>Da li ste ikada bili pod istragom za neko krivično delo?</i> PO / DA <input type="checkbox"/> JO / NE <input type="checkbox"/></p>					
Data kur kanë nisur hetimet/ <i>Datum kada je započeta istraga</i>				Data kur kanë përfunduar hetimet/ Datum kada je završena istraga	
Hetimet u zhvilluan nga (institucioni) / <i>Istraga je obavljena od strane (institucija)</i>					
Qyteti / <i>Grad</i>				Shteti / <i>Država</i>	
Lloji i veprës penale / <i>Vrsta krivičnog dela:</i>					
<p>A keni qenë ndonjëherë i arrestuar apo i dyshuar për vepër penale?</p> <p><i>Da li ste ikada bili pritvoreni ili osumnjičeni za neko krivično delo</i></p> <p>PO / DA <input type="checkbox"/> JO / NE <input type="checkbox"/></p>					
Data e arrestimit / Datum pritvora			Qyteti / <i>Grad</i>		Shteti / Država
I arrestuar nga (institucioni), <i>Pritvoren od (institucija):</i>					
Arsyeja e arrestimit / <i>Razlog pritvora:</i>					
A keni qenë i akuzuar ndonjëherë për vepër penale? <i>Da li ste ikada bili optuženi za krivično delo</i>					

PO / DA <input type="checkbox"/> JO / NE <input type="checkbox"/>			
Data e ushtrimit të aktakuzës / <i>Datum podizanja optužnice</i>			
Vendi i ushtrimit të aktakuzës / <i>Mesto opt.</i>		Shteti/ Država	
I akuzuar për/ <i>Optužen za</i>			
Përshkruani rastin shkurtimisht/ <i>Opišite slučaj ukratko:</i>			
A jeni gjykuar ndonjëherë për vepër penale? <i>Dali ste ikada bili osuđeni za krivično delo?</i>			
PO <input type="checkbox"/> JO <input type="checkbox"/>			
Data e dënimit / <i>Datum presude</i>		Gjykata/ <i>Sud</i>	
Qyteti / <i>Grad</i>		Shteti/ <i>Država</i>	
I dënuar për/ <i>Osuđen za</i>			
Natyra e vendimit të gjykatës (përshkruani vendimin): <i>Priroda sudskog rešenja (opišite rešenje)</i>			
Nëse kundër vendimit të shkallës së parë është ushtruar ankesë me mjetë të rregullta juridike, ju lutemi plotësoni informacionin e kërkuar në vijim. <i>Ako je protiv prvostepene odluke podneta žalba redovnim pravnim sredstvima, molimo vas navedite tražene informacije u vezi toga:</i>			
Data e vendimit të shkallës së dytë / <i>Datum rešenja drugog tepena</i>		Gjykata e shkallës së dytë / <i>Drugo stepeni sud</i>	
Qytet/ <i>Grad</i>		Shteti/ Država	

<p><b>A u është shqiptuar ndonjë sanksion (masë apo dënim) qoftë penal, administrativ, apo tjetër, me vendim të formës së prerë, me të cilin u është ndaluar kryerja e profesionit, detyrës apo veprimtarisë, ju lutemi plotësoni informacionin e kërkuar në vijim. <i>Ako vam je izrečena neka sankcija (mera ili kazna), bilo da je krivična, administrativna, ili druga, pravosnažnom odlukom, kojom vam je zabranjeno da obavljate svoje zanimanje, dužnost ili delatnost, molimo Vas da popunite sledeće tražene podatke.</i></b></p>			
Data e vendimit të shkallës së dytë / Datum rešenja drugog stepena		Gjykata e shkallës së dytë / Drugo stepeni sud	
Qytet/ Grad		Shteti/ Država	

DEKLARATA / IZJAVA			
<p><i>Nën përgjegjësinë morale, materiale dhe penale konfirmoj që informacionet që gjenden në këtë aplikacion si dhe ato që gjenden në dokumente tjera të bashkangjitura si pjesë përbërëse e aplikacionit janë të sakta. Kuptoj që jam nën obligim të përhershëm të përmirësoj çdo informacion të pasaktë dhe të dërgoj çdo informacion relevant të cilin e mësoj pas dërgimit të këtij aplikacioni. Po ashtu kuptoj që mund të eliminohem nga mundësia për emërim në pozitë në të cilën aplikoj, respektivisht që mund të shkarkohem nga detyra në qoftë se konstatohet që kam dhënë informacione të pasakta apo kam shpier në konkludime të pasakta.</i></p> <p><i>Pod moralnom, materijalnom i krivičnom odgovornošću potvrđujem da su informacije navedene u ovom obrascu, kao i u svim dokumentima podnesenim kao njegov sastavni deo, istinite i tačne. Shvatam da sam pod trajnom obavezom da ispravim svaku netačnu informaciju i da dostavim svaku drugu relevantnu informaciju koju saznam nakon podnošenja ovog obrasca. Takođe razumem da mogu biti eliminisan iz mogućnosti da budem imenovan/a na poziciju za koju se prijavljujem), odnosno da mogu biti razrešen(a) sa funkcije, ukoliko se ustanovi da neki od podataka koje sam dostavio(la) nije tačan ili navodi na pogrešne zaključje.</i></p>			
Nënshkrimi /Potpis			
Vendi / Mesto		Data / Datum	





**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

---

**DEKLARATË**

Unë, \_\_\_\_\_, me numër personal \_\_\_\_\_, përmes kësaj Deklarate konfirmoj disponueshmërinë time për të shërbyer si anëtar i Komisionit të emëruar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me qëllim të shqyrtimit, analizimit dhe vlerësimit të aplikacionit të kandidatit dhe dokumenteve të bashkangjitura për ekspert gjyqësor në pajtueshmëri me Rregulloren Nr. 03 / 2022 Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet dhe Shpërblimin e Ekspertëve Gjyqësor dhe legjislacioni në fuqi.

Në të njëjtën kohë, përmes nënshkrimit të kësaj Deklarate, dëshmoj se:

- Kam lexuar Rregulloren Nr. 03 / 2022 Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet dhe Shpërblimin e Ekspertëve Gjyqësor;
- Pajtohem me anëtarësinë në Komision;
- Pajtohem të mbaj paanshmërinë dhe profesionalizmin tim në vlerësimin e kandidatëve;
- Pajtohem të punoj në bashkëpunim të ngushtë me stafin përgjegjës të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Pajtohem që gatë procesit të certifikimit dhe emërimin të eksperteve gjyqësor të bëj përpjekje maksimale që të parandalojnë dhe /ose të shmangem nga çfarëdo situatë të konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.
- Pranoj që personalisht mund të konsiderohem përgjegjës nga aspekti penal dhe/ose civil për shpalosjen e informatave koefidenciale të bërë me qëllim ose për shkak të pakujdesisë.

Emri Mbiemri: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Vendi: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA – KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



**Certifikatë/Sertifikat/Certificate**  
**Nr./Br./No. 001**

\_\_\_\_\_  
EMRI – IME (EMRI I PRINDIT-IME RODITELJA) MBIEMRI – PREZIME, NR PERSONAL-LIÇNI BROJ-PERSONAL  
NUMBER

Është certifikuar si/Sertifikovani je/It is certified as

**EKSPERT GJYQËSOR NË FUSHËN / SUDSKI VEŠTAK U OBLASTI/ JUDICIAL EXPERT FOR**

Në Prishtinë, më datë:/ U Prištini, dana /  
In Prishtina, on \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
Albert Zogaj  
Kryesues/Predsedavajući/Chair  
Këshilli Gjyqësor i Kosovës/ Sudski Savet Kosova/ Kosovo Judicial Council



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

	Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	
Nr.Br.No.	01 / 1390	
DATUMI	26.10.2022	
	PRISHTINË - A	

**KGJK.nr.399/2022**



**Datë: 20 tetor 2022**

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 dhe 1.24 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 30 të Rregullores Nr. 03/2020 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen 296-të, të mbajtur me datë 20 tetor 2022, merr këtë:

## V E N D I M

- I. Miratohen Shtojca 4 dhe 6 të Rregullores Nr. 03/2022 për Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet dhe Shpërblimin e Ekspertëve Gjyqësor.
- II. Obligohet Sekretariati i KGJK-së, të publikoj shtojcat në ueb faqe të KGJK-së.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 20 tetor 2022.

**Albert ZOGAJ,**  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.





**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

---

**SHTOJCA 4. LISTA E SHËRBIMEVE TË CILAT INSTITUTI I MJEKËSISË  
LIGJORE I OFRON ME PAGESË**

**Neni 1**  
**Dispozitat e përgjithshme**

Shtojca 4 e Rregullores Nr.03/2022 për Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet dhe Shpërblimin e Eksperteve Gjyqësor, në pajtueshmëri me nenin 17 paragrafi 1 dhe 2 të rregullores, përcakton listën e shërbimeve / ekspertizave që ofrohen nga Instituti i Mjekësisë Ligjore me pagesë, e të cilat nuk përcaktohen në nenin 15, paragrafi 4 të Rregullores.

**Neni 2**

1. Ekspertiza mjeko - ligjore bazuar në dokumentacionin e çështjes deri në dy (2) të dëmtuar shpërblehet në shumë prej njëzet (20.00) €
2. Ekspertiza mjeko - ligjore bazuar në dokumentacionin e çështjes mbi dy (2) të dëmtuar shpërblehet në shumë prej pesëdhjetë (50.00) €

**Neni 3**

Pjesëmarrja e ekspertit në rekonstrukcionin e vendit të ngjarjes shpërblehet në shumë prej pesëdhjetë (50.00) € deri në njëqind (100.00) € Peshë e lëndës merret si kriter për caktimin e shpërblimit.

**Neni 4**

Për të gjitha shërbimet / ekspertizat tjera të ofruara me pagesë nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, të cilat nuk rregullohen me nenin 2 dhe 3 të kësaj shtojce, shpërblimi caktohet sipas dispozitave të nenit 15, paragrafit 4 të Rregullores.

**Neni 5**

Kjo shtojcë hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

---

**SHTOJCA 6. SHËRBIMET ME PAGESË TË INSTITUCIONEVE TJERA  
PUBLIKE DHE TË SPECIALIZUARA TË CILAT NUK JANË  
PËRFSHIRË NE SHTOJCËN 4 DHE 5 TË KËSAJ  
RREGULLORE**

**Neni 1**  
**Dispozitat e përgjithshme**

Shtojca 6 e Rregullores Nr.03/2022 për Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet dhe Shpërblimin e Ekspertëve Gjyqësor, në pajtueshmëri me nenin 17 paragrafi 1 dhe 2 të rregullores, përcakton shërbimet / ekspertizat profesionale me pagesë që ofrohen nga institucionet tjera publike dhe të specializuara, të caktuara me vendim të gjykatës / prokurorisë, e të cilat nuk janë paraparë në shtojcën 4 dhe 5 të kësaj rregullore.

**Neni 2**


Për të gjitha institucionet tjera publike dhe të specializuara të cilat sipas vendimit të gjykatës / prokurorisë ofrojnë shërbime profesionale / ekspertizë me pagesë, e për cilat nuk është paraparë shpërblimi në shtojcën 4 dhe 5 të kësaj rregullore, shpërblimi për shërbimet / ekspertizat e kryera do të caktohet sipas nenit 15, paragrafi 4 të rregullores.

**Neni 3**

Kjo shtojcë hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL




KGJK.nr.471/2022  
Datë: 14 dhjetor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1.12 dhe 1.24 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 30 të Rregullores Nr. 03/2020 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen 300-të, të mbajtur me datë 14 dhjetor 2022, merr këtë:

### V E N D I M

- I. Miratohet shtojca 5 e Rregullores Nr. 03/2022 për Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet dhe Shpërblimin e Ekspertëve Gjyqësor, në lidhje me listën e shërbimeve për të cilat Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës ofron me pagesë.
- II. Obligohet Sekretariati i KGJK-së, të publikoj shtojcën në ueb faqe të KGJK-së.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 14 dhjetor 2022.

Albert ZOGAJ,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Komisionit për Çështje Normative;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDESKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

---

**SHTOJCA 5. LISTA E SHËRBIMEVE TË CILAT INSTITUTI I PSIKIATRISË  
FORENZIKE TË KOSOVËS OFRON ME PAGESË**

**Neni 1**  
**Dispozitat e përgjithshme**

Shtojca 5 e Rregullores Nr.03/2022 për Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet dhe Shpërblimin e Eksperteve Gjyqësor, në pajtueshmëri me nenin 17 paragrafi 1 dhe 2 të rregullores, përcakton listën e shërbimeve / ekspertizave që ofrohen nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike me pagesë, e të cilat nuk përcaktohen në nenin 15, paragrafi 4 të Rregullores.

**Neni 2**

1. Për ekspertizë të caktuar me vendim të gjykatës / prokurorisë, e cila kryhet nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike në kuadër të detyrave të rregullta dhe obligimeve që sipas ligjit i ka ky Institut, shpërblimi nuk lejohet.

2. Përfundimisht paragrafit 1 të këtij neni, për shërbimet / ekspertizat e caktuara me vendim të gjykatës / prokurorisë, të cilat për ndonjë shkak të arsyetuar nuk mund të kryhen nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike, caktimi dhe shpërblimi i ekspertit do të bëhet sipas dispozitave të nenit 13 paragrafi 1 dhe nenit 15 paragrafi 4 të rregullores.

**Neni 3**

Nëse për ekspertizën e kryer sipas paragrafit 1 të nenit 2 të kësaj shtojce, gjykata / prokuroria e fton ekspertin që të jap sqarim / plotësim në seancë, eksperti për pjesëmarrje në seancë shpërblehet në shumë prej pesëdhjetë (50,00) € deri në njëqind (100.00) € Pesha e lëndës merret si kriter për caktimin e shpërblimit.

**Neni 4**

Kjo shtojcë hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.